



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 19 , datë 01.07. 2025

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS
KANALIZIME KORÇË sh.a

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539 datë 30.12.2021 "*Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime*" (**Vendim KKRR nr.539**) i ndryshuar,

Komisioni Kombëtar Rregullator

Në mbledhjen e datës 01.07.2025 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

Konstaton se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a. me shkresën nr. 653 prot, datë 27.06.2024, me lëndë "Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura" ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifar për shërbimet ujësjellës kanalizime sipas tabelës nr.1 të mëposhtme:

Tabela nr.1: Tarifat Aktuale dhe të Propozuara nga Shoqëria Rajonale UK Korçë për vitet 2025-2029.

Kategoria e Klientëve				A. Shërbimi i FU		B. Shërbimi i KUN		D. Tarifë Fikse Shërbimi	
				Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara	Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara	Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara
					Viti		Viti		Viti
					2025-2029		2025-2029		2025-2029
				Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/muaj	Lek/muaj
Shoqëria Rajonale UK Korçë	Zona A	Njësia Korçë	1. Klientë Familjarë	72	72	42	48	140	200
			2. Klientë Publik	117	140	64	80	140	200
			3. Klientë Privat	140	140	64	80	140	200
	Zona B	Mollaj, Bulgarec qendër, Voskopojë, Vithkuq, Bulgarec, Drenove	1. Klientë Familjarë	38/28	50	0	20	100	200
			2. Klientë Publik	110	140	0	30	100	200
			3. Klientë Privat	100	140	0	30	100	200
		*Njësia Maliq-Me matës /Zona malore & fushore	1. Klientë Familjarë	45/22.5	50	50/0	20	54/27	200
			2. Klientë Publik	100	140	50/0	30	54	200
			3. Klientë Privat	105	140	50/0	30	54	200
		*Njësia Maliq-Pa matës aforfe/Zona malore & fushore	1. Klientë Familjarë	450/225 (lek/muaj)	50	50/0	20	54/27	200
			2. Klientë Publik		140	0	30	0	200
			3. Klientë Privat		140	0	30	0	200
		Njësia Devoll	1. Klientë Familjarë	38	50	0	20	50	200
			2. Klientë Publik	100	140	0	30	50	200
			3. Klientë Privat	110	140	0	30	50	200
		Njësia Kolonjë	1. Klientë Familjarë	38	50	10	20	100	200
			2. Klientë Publik	100	140	13	30	100	200
			3. Klientë Privat	110	140	18	30	100	200
		Njësia Pustec	1. Klientë Familjarë	50	50	0	20	100	200
			2. Klientë Publik	100	140	0	30	100	200
			3. Klientë Privat	100	140	0	30	100	200

* Tarifa të pa miratuara nga ERRU, por të vendosura sipas vendimeve të këshillave bashkiake përkatëse

- Me vendimin e KKRR nr. 27, datë 12.09.2024 “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifar të Shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a.”, Komisioni Kombëtar Rregullator vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të SHRUK Korçë.
- Kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a, për vendosjen e nivelit të ri tarifar për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në Vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021.
- Shoqëria Rajonale UK Korçë aplikon tarifat e miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese sipas:
 - Vendimit të KKRR Nr.56, datë 29.12.2017 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për sh.a UK Korçë;

- b. Vendimit të KKRR Nr.11, datë 16.02.2018 “ Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për sh.a UK Maliq;
 - c. Vendimit të KKRR Nr. 14, datë 31.03.2015 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për konsum publik për shoqërinë ujësjellës kanalizime për sh.a UK Ersekë”;
 - d. Vendimit të KKRR Nr. 42, datë 23.12.2011 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a UK Bilisht”.
5. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:
- a) Nevoja për tarifa të miratuara nga ERRU për gjithë zonën e shërbimit me tendencë unifikimin e tyre;
 - b) Nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi mbi 100% i kostove operacionale;
 - c) Aplikimi për nivel të ri tarifor për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe pagës minimale ndër vite;
 - d) Përmirësim i cilësisë së shërbimeve të ofruara të FU dhe KUN si rezultat i investimeve të parashikuara;
 - e) Tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit;
6. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave të përcaktuar në Vendimin e KKRR nr.539, datë 30.12.2021, ERRU ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit.
7. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Rajonale Korçë sh.a e kritereve të mëposhtme:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë sa i takon mbrojtjes së konsumatorëve nga çmimet monopol dhe mbrojtjen e interesave të tyre në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, sa i takon mos lejimit të abuzimit me pozitën dominuese në treg, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve, pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes dhe të konkurrentëve të tjerë, pengesat në hyrje në tregun përkatës dhe konkurrencën potenciale;
 - c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar;
 - d) Kërkesave të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”;
 - e) Orientimin e tarifave drejt mbulimit të Kostove Totale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

- f) Tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;
8. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU ka vendosur detyra për t'u realizuar nga UK Rajonale Korçë sh.a si më poshtë:
- a. T'i kushtohet vëmendja maksimale instalimit të matësave në prodhim për të gjithë burimet, si dhe atyre familjarë të parashikuar, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrihet objektivi i vendosur nga ERRU për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;
 - b. Të kryejë vlerësimin e “Ujit të Prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet me dhe pa ujëmatës;
 - c. Të trajnojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të patur situatë reale mbi UPA dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të Bilancit të Ujit për vitin 2024 dhe në vazhdim;
 - d. Të mbajë aktive vazhdimisht Task-Forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;
 - e. Për aplikimin tarifor të radhës (jo më vonë se qershor 2029), duke qenë se shoqëria në fund të periudhës rregullatore 2025-2029 do të arrijë të mbulojë 100% të Kostove Totale, në këtë aplikim të pritshëm shoqëria do të aplikojë sipas metodës “Çmim Tavan” të metodologjisë së tarifave, i cili kërkon që të jetë detyrues i shoqëruar me Planin e Biznesit 5- vjeçar i aprovuar paraprakisht nga ERRU. Për këtë qëllim shoqëria duhet të ketë parasysh që brenda vitit 2029 të ketë hartuar Planin e Biznesit 5-vjeçar duke përdorur si vit bazë të dhënat e çertifikuara të vitit 2028, i cili duhet të shoqërohet me planet përkatëse të veprimit të mbështetura me projekte dhe me burimet e financimit;
 - f. Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara për të planifikuar prioritetet e inestimeve në të ardhmen e afërt në mënyrë që të evitohet vjetërimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme, e cila lidhet ngushtësisht me strategjinë e zvogëlimit të humbjeve nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të çënimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet;
 - g. Të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të paktën për vitin 2028, si një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e radhës;
 - h. Me mbështetjen e Task Forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si, monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa on-line dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë;

- i. Treguesi i efektivitetit të stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumenta mbështetëse. Për këtë duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri;
 - j. Ti kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të këtyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi efektivitetin e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë;
9. Në mbledhjen e datës 09.06.2025 Komisioni Kombëtar Rregullator konkludoi mbi projektvendimin për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Referuar analizës tekniko - ekonomike, ERRU e gjen të justifikuar kërkesën e shoqërisë për ndryshimin e nivelit tarifar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria.
10. Me shkresën nr. 323/10 dhe nr. 323/11, datë 10.06.2025, me lëndë “Mbi aplikimin për nivel të ri tarifar të shoqërisë Rajonale UK Korçë”, ERRU ka përcjellë për komente projektvendimin e shoqëruar me relacionin përkatës pranë shoqërisë UK Rajonale Korçë, AKUK, Autoritetit të Konkurrencës dhe bashkive Korçë, Maliq, Devoll, Kolonjë dhe Pustec., për të cilën vetëm SHR UK Korçë ka kthyer përgjigje.
11. Shoqëria Rajonale UK Korçë me shkresën nr. 469/1 prot, datë 19.06.2025 me lëndë “Shprehje mendimi në lidhje me projektvendimin e tarifave të reja të shërbimit të shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Korçë sh.a ka kërkuar rishikimin e tarifave të furnizimit me ujë për klientët jofamiljarë të Zonës B (njësia administrative Korçë Rurale, Maliq, Bilisht, Pustec dhe Kolonjë) dhe propozon tarifë të unifikuar për gjithë zonën B.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me Vendim nr. 539, datë 30.12.2021 “*Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime*”, i ndryshuar dhe nuk mori në konsideratë kërkesën e shoqërisë për unifikimin e tarifave për klientët jo familjarë për zonën B pasi nuk respektohet koeficienti i ndër financimit ndërmjet kategorive të klientëve sipas parashikimeve të kësaj metodologjie, arrin në konkluzionin se sipas analizës së kryer, tarifat janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjorë referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “*Për mbrojtjen e konkurrencës*”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “*Për mbrojtjen e konsumatorëve*”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë sh.a si më poshtë:

Tabela nr.2: Tarifat e miratuara nga ERRU për shoqërinë Rajonale UK Korçë

Kategoria e Klientëve			Tarifa				
			2025	2026	2027	2028	2029
ZONA A	Njësia Korçë/Urbane	A. Shërbimi i FU	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³
		1. Klientë Familjarë	72	72	72	72	72
		2. Klientë Publik	140	140	140	140	140
		3. Klientë Privat	140	140	140	140	140
		B. Shërbimi i KUN	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³
		1. Klientë Familjarë	48	48	48	48	48
		2. Klientë Publik	80	80	80	80	80
		3. Klientë Privat	80	80	80	80	80
		C. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë Familjarë	200	200	200	200	200
		2. Klientë Publik	200	200	200	200	200
		3. Klientë Privat	200	200	200	200	200
	*Njësia Rurale Korçë	A. Shërbimi i FU	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³
		1. Klientë Familjarë	50	50	50	50	50
		2. Klientë Publik	110	110	110	110	110
		3. Klientë Privat	100	100	100	100	100
		B. Shërbimi i KUN	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³
		1. Klientë Familjarë	20	20	20	20	20
		2. Klientë Publik	30	30	30	30	30
		3. Klientë Privat	30	30	30	30	30
		C. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë Familjarë	200	200	200	200	200
		2. Klientë Publik	200	200	200	200	200
		3. Klientë Privat	200	200	200	200	200
ZONA B	Njësia Maliq	A. Shërbimi i FU	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³
		1. Klientë Familjarë	50	50	50	50	50
		2. Klientë Publik	100	100	100	100	100
		3. Klientë Privat	105	105	105	105	105
		B. Shërbimi i KUN	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/m ³
		1. Klientë Familjarë	20	20	20	20	20
		2. Klientë Publik	30	30	30	30	30
		3. Klientë Privat	30	30	30	30	30
		C. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë Familjarë	200	200	200	200	200

	*Njësia Devoll	2. Klientë Publik	200	200	200	200	200
		3. Klientë Privat	200	200	200	200	200
		A. Shërbimi i FU	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë Familjarë	50	50	50	50	50
		2. Klientë Publik	100	100	100	100	100
		3. Klientë Privat	110	110	110	110	110
		B. Shërbimi i KUN	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë Familjarë	20	20	20	20	20
		2. Klientë Publik	30	30	30	30	30
		3. Klientë Privat	30	30	30	30	30
		C. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë Familjarë	200	200	200	200	200
		2. Klientë Publik	200	200	200	200	200
		3. Klientë Privat	200	200	200	200	200
	Njësia Kolonjë	A. Shërbimi i FU	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë Familjarë	50	50	50	50	50
		2. Klientë Publik	100	100	100	100	100
		3. Klientë Privat	110	110	110	110	110
		B. Shërbimi i KUN	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë Familjarë	20	20	20	20	20
		2. Klientë Publik	30	30	30	30	30
		3. Klientë Privat	30	30	30	30	30
		C. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë Familjarë	200	200	200	200	200
		2. Klientë Publik	200	200	200	200	200
		3. Klientë Privat	200	200	200	200	200
	*Njësia Pustec	A. Shërbimi i FU	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë Familjarë	50	50	50	50	50
		2. Klientë Publik	100	100	100	100	100
		3. Klientë Privat	100	100	100	100	100
		B. Shërbimi i KUN	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³
		1. Klientë Familjarë	20	20	20	20	20
		2. Klientë Publik	30	30	30	30	30
		3. Klientë Privat	30	30	30	30	30
		C. Tarifë Fikse Shërbimi	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
		1. Klientë Familjarë	200	200	200	200	200
		2. Klientë Publik	200	200	200	200	200
		3. Klientë Privat	200	200	200	200	200

*Njësive Pustec, Devoll dhe ruralet e njësive Korçë do ju zbatohet tarifa e shërbimit për KUN në momentin që shoqëria do ju ofroj shërbimin e kanalizimeve pasi aktualisht këto njësi nuk e kanë këtë shërbim.

2. Objektivat e Treguesve të Performancës të vendosura nga ERRU deri në fund të vitit 2026 janë:

Tabela nr.3: Objektivat e Treguesve të Performancës (TKPs)

				Niveli i TKP						Objektivat sipas ERRU
TKP	№	Emri i TKP-ve	Njësia TKP	Raportimi bazë	Parashikimi					në fund të vitit 2026
				2023	2025	2026	2027	2028	2029	
Mbulimi me shërbim	1.1	Mbulimi me FU	%	78.67	78.25	78.22	78.20	78.17	78.15	79
	1.2	Mbulimi me KUN	%	51.51	54.34	57.32	60.47	63.79	67.30	58
	1.3	Mbulimi me ITUN	%	29.51	29.94	30.23	31.93	34.77	39.20	31
TKP Teknikë	2	Uji pa të Ardhura	%	35.82	35.17	33.67	33.33	33.00	32.66	33
	3	Niveli i Matjes	%	96	100	100	100	100	100	100
	4	Vazhdimësia e FU	orë/ditë / popullsi	22.26	23.19	23.39	23.47	23.53	24.00	23
	5	Efikasiteti i Energjisë për ujin	kWh/m3	0.61	0.56	0.55	0.54	0.53	0.52	0.55
	6	Efienca e Stafit	nr/nr/1000	1.29	1.29	1.30	1.25	1.23	1.18	1.2
Shërbimi ndaj klientit	7.1	Ankesat e Klientëve	%	5.26	5.28	5.26	5.23	5.21	5.19	5.2
	7.2	Ankesat e Klientëve që kanë marrë përgjigje	%	97.66	96.67	96.67	96.67	96.67	96.67	100
TKP Financiare	8.1	Norma Korrente e Arkëtimit	%	93.63	91.69	88.28	85.73	82.75	80.72	92
	8.2	Norma e Përgjithshme e Arkëtimit	%	107.93	103.49	99.63	96.76	93.39	91.10	105
	9.2	Mbulimi O&M për të tre shërbimet	%	115.90	127.91	128.05	128.56	128.97	129.36	130
	10.1	Mbulimi i Kostos Totale për tre shërbimet	%	30.23	32.26	33.08	34.13	34.47	34.56	33

3. Vendimi i KKRR nr.56, datë 29.12.2017 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për sh.a UK Korçë, Vendimi i KKRR nr.11, datë 16.02.2018 “ Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për sh.a UK Maliq, Vendimi i KKRR nr. 14, datë 31.03.2015 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për konsum publik për shoqërinë ujësjellës kanalizime për sh.a UK Ersekë”, Vendimi i KKRR nr. 42, datë 23.12.2011 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sha UK Bilisht” shfuqizohen.
4. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh. a. do të jetë 0.77% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.
5. UK Rajonale Korçë sh.a detyrohet të nënshkruajë kontratën “Për aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU dhe shlyerjen e pagesës rregullatore” brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.08.2025 dhe është i vlefshëm deri në 31.12.2029.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

GERTA LUBONJA